



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Librazhd, me 28.12.2023.

**Shtojca 13**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Drejtuar: " **OE"KAPRI " shpk me nr.Nipti: K52214502D dhe me adrese: "Lagjia 14 ,rruga Bajram Tusha ,Durrës**

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra .

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF:89003-11-24-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “ **Blerje pajisje mobilerie per shkollen 9-vjecare Dragostunje”**

**Afati i realizimit te sherbimit :15 dite**

**Fondi limit: 1 056 410 (nje milion e pesedhjetë e gjashtë mijë e katerqind e dhjetë ) leke pa tvsh**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1.OE “Kapri Shpk ” me nr.Nipti: K52214502D , me oferte ekonomike 1 033 310 (nje milion tridhjetë e tre mijë e treqind e dhjetë ) leke pa tvsh.**

**2. OE “SHAGA.”shpk me Nr. NIPT J96822229J, me oferte ekonomike 902,275 (nenteqind e dy mijë e dyqind e shtatedhjetë e pese )leke pa tvsh.**

Eshte skualifikuar Operatori OE “SHAGA.”shpk me Nr. NIPT J96822229J, me oferte ekonomike 902,275 (nenteqind e dy mije e dyqind e shtatedhjete e pese )leke pa tvsh nuk ka arritur te permbushe kriterin e kualifikimit te percaktuar ne dokumentet standarte te tenderit si me poshte vijon:

**SE PARI :**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Formulari përmbledhes i vetedeklarimit si dokumenti me i rendesishem I DST nuk eshte i nenshkruar ne cdo faqe nga operatori ekonomik.

Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.**

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

Në nenin 39, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të

përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

**Referuar ligjit të prokurimit publik, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, rezulton, se për një pjesë të kriterëve të pranimit të kërkuara në dokumentet e tenderit, operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimitte plotë dhe të nënshkruar në cdo faqe si një provë paraprake në formën e një deklaratë, ku ofertuesi shprehet se oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit,**

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KVO , konstaton se, për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) të nënshkruar në vetëm një faqe dhe të panëshkruar në faqet e tjera.**

Vendosja e kriterëve të kualifikimit ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.**

**KVO sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.**

KVO sqaron, se operatori ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës dhe në përgatitjen e saj duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Për më tepër, vetë autoriteti kontraktor në hartimin e këtij kriteri kualifikues ka kërkuar që të plotësohet me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit.

**Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.**

**Në rastin konkret rezulton, se kriteri 2.1 i kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit në dokumentat e tenderit, nuk është plotësuar në mënyrë të sakte dhe të plotë nga ana e operatorit ekonomik "SHAGA"shpk.**

**SE DYTI** : Operatori OE” “SHAGA.”shpk me Nr. NIPT J96822229J, me oferte ekonomike 902,275 (nenteqind e dy mije e dyqind e shtatedhjete e pese )leke pa tvsh nuk ka arritur te permbush kriterin e kualifikimit nr. 2.3.5 te percaktuar ne dokumentet standarte te tenderit si me poshte vijon:

*2.3.5.Operatori ekonomik duhet te ofroje garanci per mallrat e ofruar si dhe nderrimin ne rast se nuk jane sipas specifikimeve teknike te percaktuara nga AK . Per permbushjen e kesaj pike operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate te nenshkruar nga perfaqesuesi ligjor se operatori merr persiper zevendesimin e mallrave dhe levrimin sipas specifikimeve teknike te percaktuara nga AK. Gjithashtu operatori ekonomik te perfshije ne deklarate duke garantuar AK se ofron **garanci** per mallrat objekt prokurimi duke i'u referuar periudhes se kerkuar ne specifikimet teknike.*

**Deklarata e garancise se ngarkuar ne SPE nga OE nuk eshte sipas formatit te percaktuar ne DST. OE nuk ofron garanci dhe nuk mban pergjegjesi per nderrimin e mallrave sipas specifikimeve teknike .**

Vendosja e kriterëve të kualifikimit ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. **Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.**

**KVO sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.**

**Në rastin konkret rezulton, se kriteri 2.3.5 i kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriteret e vecanta të kualifikimit në dokumentat e tenderit, nuk është plotësuar ne menyre te sakte dhe te plote nga ana e operatorit ekonomik “SHAGA”shpk duke shmangur pergjiesine per dhenien e nje garancie te plote.**

**SE TRETË** : Operatori OE” “SHAGA.”shpk me Nr. NIPT J96822229J, me oferte ekonomike 902,275 (nenteqind e dy mije e dyqind e shtatedhjete e pese )leke pa tvsh nuk ka arritur te permbush kriterin e kualifikimit te percaktuar ne dokumentet standarte te tenderit si me poshte vijon:

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra për artikujt ne preventiv (nga 1 cope/1 artikull) . Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit para Zyres se Protokollit te bashkise Librazhd, ato duhet të jenë të mbyllura ne kuti jo transparente të vulosur, së bashku me mostrat, ofertuesi duhe të bejë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave eshte kusht skualifikim.

Synimi i autoritetit kontraktor lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderi. Për vlerësimin e ofertës teknike nga operatorët ekonomikë,

**Duke marrë shkas nga natyra e mallrave të cilat kërkohet dorëzim i mostrave përkatëse nga ana e autoritetit kontraktor, KVO konstaton se, këto të fundit duhet te shfaqen në cilësinë e produktit final dhe asnjëherë të lëndës së parë për përfitimin e produktit final e njëherazi kontrolli më përpara (ex-ante) i përputhshmërisë së specifikimeve teknike me kërkesat e autoritetit kontraktor shfaqet i vështirë për tu realizuar dhe synimi i autoritetit kontraktor nuk përmbushet.**

**Sa më sipër, duke u nisur edhe nga natyra e mallrave të kërkuar nga autoriteti kontraktor, KVO , gjykon se, dorëzimi I mostrave të sipërcituara nuk është I plote dhe I sakte për vlerësimin e ofertës teknike në kuptim të LPP dhe RRPP.**

Vendosja e kriterëve të kualifikimit ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. **Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. KVO sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.**

**Persa me siper OE "SHAGA."shpk skualifikohet per mospermbushje te kriterëve te kerkuara ne DST.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE"KAPRI "** shpk me nr.Nipti: **K52214502D** dhe me adrese: **"Lagjia 14 ,rruga Bajram Tusha ,Durrës** *Se oferta e parqitur me një vlerë të përgjithshme prej 1 033 310 (një milion tridhjetë e tre mijë e treqind e dhjetë ) leke pa tvsh. , , /pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si fitues i procedurës së prokurimit bazuar ne kriterin e cmimit me te ulet te ofertave te vlefshme.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Librazhd, Sektori Juridik dhe Prok.Publike sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej ----- ], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

**PER AUTORITETIN KONTRAKTOR**

**BASHKIA LIBRAZHD**

**PERSONI I AUTORIZUAR**

**SEKRETARI I PERGJITHSHEM  
BAJRAM PISHKASHI**